

## KOMITETI DREJTUES

Tiranë, 2 Shkurt 2023

Nr. 12 Prot.

### Vendim Nr.1 i KD-së

Kryesia e FSHB-së në mbledhjen e sajë më datë 1 shkurt 2023, drejtuar nga Presidenti i FSHB-së, Z. Avni Ponari dhe prezencë të anëtarëve, Znj. Edera Alibegaj, Znj. Migena Plasa, Z. Dritan Mema, Z. Juel Jarani, Z. Blendi Dibra dhe Z. Klevis Kaso, diskutuan mbi rendin e ditës si vijon:

1. Kupa e Shqipërisë (M-F);
2. Ndryshimet në Rregulloren e Aktiviteteve Kombëtare të Basketbollit;
3. Rifillimi i kampionateve kombëtare (M-F) dhe rishikimi i kalendarit për shkak të bllokimit të pallateve të sportit në periudhën e zgjedhjeve vendore;
4. Ndeshjet e ekipit kombëtar femra, Slloveni dhe Turqi, në 9-12 shkurt 2023;
5. Problematika e për pjesëmarrjen me ekipin kombëtar U20 vajza 2023;
6. Procedura e përzgjedhjes së trajnerëve të ekipeve kombëtare për moshat në turnetë europian të verës 2023;
7. Fillimi i kampionateve kombëtare U16 (D-V) dhe problematika e pjesëmarrjes së shoqatave jo anëtare në kampionatet kombëtare;
8. Mbyllja e pagesave për gjyqtarët e angazhuar në ndeshjet e JrNBA Albania 2022;
9. Të ndryshme.

## Për sa më sipër KD-ja vendosi:

1. Për organizimin e Kupës së Shqipërisë u përcaktua formati organizativ dhe detyrimi i pjesëmarrjes së të gjitha ekipeve që konfirmojnë pjesëmarrjen me meshkuj dhe femra të rritur/a;
2. Në Rregulloren e Aktiviteteve Kombëtare të Basketbollit u rishikuan në mënyrë thelbësore disa nene duke miratuar ndryshimet e përcaktuara si të nevojshme për rritjen dhe mbrotjen e lojtarëve vendorë dhe ndryshime të tjera të nevojshme për njësimin me rregulloren e FIBA-s;
3. Miratim për ndryshimet e datave të kalendarëve për kampionatet meshkuj dhe femra të rritur/, faza e dytë dhe faza finale, duke përshtatur mundësitë e sallave sportive të cilat priten të bllokohen si VNV përgjatë periudhës së zgjedhjeve vendorë;
4. Miratim për realizimin e shpenzimeve të nevojshme organizative përgjatë grumbullimit dhe ndeshjeve të ekipit kombëtar femra, Slloveni dhe Turqi, në 9-12 shkurt 2023. Ekipi kombëtar femra do të grumbullohet në ambientet e akademisë Dhimitraq Goga, ku dhe do të realizojë ndeshjen e fundit për “FIBA Women’s Eurobasket 2023 Qualifiers”, kundër ekipit të Turqisë, më 12 shkurt 2023;
5. Urdhër zyrës së FSHB-së për realizimin e formularit elektronik për aplikimin e trajnerëve të interesuar në drejtimin e ekipeve kombëtare të moshave për vitin 2023. Pritja e aplikimeve do të jetë përgjatë muajit shkurt 2023;
  - U20D - Div. B – Shkup, 7 deri 16 korrik 2023;
  - U16D - Div. C – Prishtinë, 19 deri 27 korrik 2023;
  - U16V - Div. C – Andorra, 18 deri 23 korrik 2023;
  - U18D - Div. B – Portugali, 21 deri 30 korrik 2023;
  - U18V - Div. C – Durrës, 1 deri 6 gusht 2023;
6. Miratim për fillimin e kampionateve kombëtare U16 (D-V) me shoqatat anëtare të FSHB-së. Shoqatat jo anëtare do të lejohen të marrin pjesë me tarifë dyfish të pjesëmarrjes dhe pa të drejtën e përdorimit të logos zyrtare të FSHB-së në fanellat e ekipit;
7. Pagesat për gjyqtarët e angazhuar në ndeshjet e JrNBA Albania 2022 do të realizohen në vlerën e 1000 lekë neto për një ndeshje gjykimi. Shlyerja e detyrimeve do të realizohet me miratim të presidentit pas realizimit të projekt sponsorizimit për këtë kategori për edicionin 2023;
8. Miratim të vendimit për dietat e shërbimit mbi kompensimin e shpenzimeve të punonjësve të administratës, të dërguar me shërbim jashtë qytetit dhe jashtë vendit.